

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË  
"HYDRPOWER-SAS" SHPK**

Datë 01.03.2019

*Znj. Olimbi Gjika, e bija e Spiro, lindur më 24.05.1957, në Përmet, mbajtëse e kartës së identitetit nr, 024610794. me nr, personal F75524099Q, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të shoqërisë "WONDER" SHPK, me adresë Rruga Ismail Qemali, pll. 11/1, Qendra e Biznesit kt. 3-të, Tiranë dhe NIPT K11624001V, e autorizuar për të themeluar një shoqëri të re tregtare në Shqipëri, duke kuptuar plotësisht legjislacionin Shqiptar në lidhje me shoqëritë tregtare si dhe duke patur në dispozicion të gjitha mjetet e nevojshme financiare si dhe idetë për të themeluar një biznes, nëpërmjet këtij akti, të hartuar dhe nënshkruar sot më datë 01.03.2019, shpreh vullnetin e saj të lirë dhe angazhimin për të themeluar një "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar", si vijon:*

**1. Forma ligjore dhe emri i shoqërisë.**

Emri i shoqërisë do të jetë "HYDROPOWER-SAS" SHPK, e quajtur më poshtë me emrin "shoqëria", e cila themelohet si një shoqëri tregtare në formën e "Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "SHPK"

**2. Ortakët e shoqërisë.**

Ortak i vetëm i shoqërisë është shoqëria "WONDER" SHPK, me adresë Rruga Ismail Qemali, pll. 11/1, Qendra e Biznesit, kt. 3-të, Tiranë dhe NIPT K11624001V.

**3. Objekti i veprimtarisë.**

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë ekskluzivisht veprimtaria koncesionare, mirëmbajtja, operimi dhe administrimi i HEC Sasaj, në përputhje me të drejtat e detyrimit e parashikuara në Marrëveshjen e Koncesionit të datës 23.07.2004 si dhe kontratës së Operim dhe Mirëmbajtje të firmosur me Koncesionarin. Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet të ligjshëm në përmbushje të objektit kryesor më sipër.

**4. Selia e shoqërisë.**

# “HYDROPOWER-SAS” SHPK

---

- Selia e Shoqërisë dhe Zyra Qendrore do të jetë në adresën: Hidrocentrali i Sasaj, Bunec, Sarandë, Shqipëri.

- Shoqëria do të ketë adrese sekondare në zyrën: Rruga “Ismail Qemali”, Pll. 11 kt, Qendra e Biznesit, kati III-të, Tiranë, Shqipëri. Shoqëria, sipas nenit 9 të ligjit Nr.9901/2008 mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen, vetëm me vendim të ortakut të vetëm të shoqërisë.

## **5. Kohëzgjatja e shoqërisë.**

Afati i veprimtarisë së shoqërisë është i pacaktuar, por përfundon me përfundimin e periudhës koncesionare në datën 23.07.2034, të përcaktuar në Marrëveshjen e Koncesionit të miratuar me VKM nr. 501 datë 23.07.2004. Afati i veprimtarisë së shoqërisë fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

## **6. Kapitali themeltar.**

6.1 Kapitali fillestar i shoqërisë është 100 (njëqind) lekë. Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tij të mëposhtëm:

6.2 Ortaku themelues shpëqëria “Wonder” Shpk: Zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100 lekë që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

## **7. Organet vendimmarrëse të shoqërisë.**

Organet vendimmarrëse të shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve.
- Administratori.

## **8. Administratori.**

- Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar. Ai zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së ortakëve. Mandati është i rinovueshëm.

- Administratori i parë i shoqërisë do të jetë Znjsh. Gledis GJIKÀ, shtetas shqiptar, lindur në Përmet, më 25.08.1990 dhe banuese në Tiranë, Bulevardi Zhan D’Ark, Pallati Wonder, nr. 47, mbajtës i passaportes me nr. personal J05825064M.

**9. Likuidimi i shoqërisë.**

Në rast falimentimi, shoqëria do të likuidohet në përputhje me dispozitat në fuqi në legjislacionin shqiptar.

**10. Regjistrimi në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit**

Ngarkohet znj. Olimbi Gjika, e bija e Spiro, lindur më 24.05.1957, në Përmet, mbajtëse e passaportes me nr, personal F75524099Q, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të shoqërisë "WONDER" SHPK, të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për depozitimin e dokumentacionit dhe regjistrimin e shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

**ORTAKU I VETËM**

**Shoqëria “WONDER” SHPK**

**Përfaqësuar nga znj. Olimbi GJIKA**



*Olimbi Gjika*

*ORTAKU I VETËM  
SHOQËRIA "WONDER" Shpk*

*Vasil*

*[Signature]*